



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/143

Datë: 13.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Ri-integrimit.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/143

Datë: 13.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik, të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i rrjetit shpërndarës unazor të transmetuesve dhe infrastrukturës përcjellëse në 22 lokacione për nevoja të institucioneve shtetërore të sigurisë në territorin e Republikës së Kosovës, sipas tabelave bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme / Ministria e Financave.
3. Obligohet Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe subjekti kërkues për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/143

Datë: 13.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim kërkesa e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për negocimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së shtetit të Katarit lidhur me rregullimin e punësimit të fuqisë punëtore në shtetin e Katarit.
2. Autorizohet Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zhvillimin e negociatave me shtetin e Katarit sipas pikës 1. të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/143

Datë: 13.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 30 të Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë, për transferimin e mjeteve të dedikuara për pagesën stimulative të performancës së profesionistëve shëndetësor, në vlerë prej 851,863.00 (tetëqindpesëdhjetenjë mijë e tetëqindgjashtëdhjetetë euro).
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi transferohen nga nën-programin "Agjencioni për Komisionimin e Përkujdesjes Shëndetësore", me kod 719, kategoria ekonomike mallrave dhe shërbimeve në nën-programin "Mjekët në vend", me kod 903, kategoria ekonomike subvencione e transfere.
3. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/143

Datë: 13.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2013, mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndodhen në Zonën Kadastrale të Komunës së Gjakovës, dhe të cilat preken nga ndërtimi i pikave për vendosjen e shtyllave elektrike dhe stabilimenteve për zgjerim të rrjetit energjetik dhe shpronësimi me vënien e të drejtës të servitutit në dobi të KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A) me kompensimin e dëmeve të pronave të pronarëve për ngastrat kadastrale, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH në mbështetjeje të Kuvendeve Komunale në territorin e të cilave gjenden zonat kadastrale, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për

kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.

6. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A) do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë